



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

11.10.2025

“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar”

ALTERNATIVA (18x 1 pikë)

1. Cilat njësitë ekonomike janë të detyruara të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për hartimin e pasqyrave financiare?

- (a) Të gjitha njësitë ekonomike, pa përjashtime me
- (b) Vetëm njësitë ekonomike me interes publik dhe rregullatorët e njësive ekonomike me interes publik në fushën e kreditimit dhe sigurimeve, përjashtuar njësitë që nuk arrijnë kriteret sasiore
- (c) Vetëm njësitë ekonomike që kanë më shumë se 50 punonjës
- (d) Vetëm biznesi me qarkullim vjetor më shumë se 100 milionë lekë
- (e) Anjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa B

2.Parimi i vijimësisë së veprimtarisë nënkupton që:

- (a) Fitimet shpërndahen çdo vit
- (b) Një entitet do të likuideojë aktivet e tij brenda vitit të ardhshëm
- (c) Subjekti nuk do të ketë borxhe
- (d) Një entitet do të vazhdojë të operojë normalisht për një të ardhme të parashikueshme brenda 12 muajve
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa D

3. Cili është qëllimi i parashikimeve në pasqyrat financiare sipas SKK 01?

- (a) Për të adresuar detyrimet e mundshme që mund të ndodhin në të ardhmen
- (b) Për të vlerësuar aktivet jomonetare
- (c) Për të siguruar informacion për vendimmarrjen menaxheriale
- (d) Për të shpërndarë fitimet
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa C

4. Një aktiv njihet në pasqyrat financiare kur:

- (a) Subjekti e kontrollon dhe pritët të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen
- (b) Ka kosto të lartë dhe është e certifikuar nga audituesi
- (c) Është dhuratë nga një aksioner
- (d) Është një aktiv i përkohshëm
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa A

5. Kërkesat ligjore të ligjit 25/2018 zbatohen për:

- (a) Vetëm për biznesin mbi 8 milion lekë qarkullim vjetor
- (b) Vetëm për shoqëritë tregtare
- (c) Vetëm për personat fizikë dhe personat juridikë
- (d) Të gjitha njësitë ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa D

6. Sipas SKK 06, “Provizionet, Detyrimet dhe aktivet e kushtezuara” cili prej perkufizimeve me poshte eshte i sakte?

- (a) Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta.
- (b) Ngjarja detyruese është ngjarja që krijon një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike. Detyrimi ligjor është detyrim që rrjedh nga një kontratë (nëpërmjet kushteve të shprehura ose të nënkuptuara të kontratës) por edhe legjislacioni apo një akt tjetër ligjor.
- (c) Detyrimi konstruktiv është detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomike ku në bazë të një modeli të vendosur nga praktikatat e shkuara, politika të shpallura ose një deklarami specifik, njësia ekonomike ua ka bërë të ditur palëve të tjera se do të pranojë përgjegjësi të caktuara, rrjedhimisht njësia ekonomike ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme të palët e tjera, se ajo do t'i shlyejë këto përgjegjësi.
- (d) Të gjitha më lart
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa D

7. Sipas SNK 16 “ Aktivet Afatgjata Materiale (Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje)”, matja dhe njohja, cilët prej me poshtë trajtohen si shembuj të kostove që NUK janë kosto e zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)?

- (a) kostot të hapjes së një reparti të ri;
- (b) kostot e prezantimit të një produkti ose shërbimi të ri (duke përfshirë kostot e reklamimit dhe aktivitetet promovuese);
- (c) kostot e kryerjes së biznesit në një vend të ri, ose me një klasë të re të konsumatorëve (duke përfshirë kostot e trajnimit të stafit)
- (d) kostot e administrimit dhe kosto të tjera të përgjithshme
- (e) Te gjitha me lart

Përgjigja e saktë është alternativa E

8. Analiza e përfitueshmërisë së një njësie ekonomike, për një periudhë të caktuar, do të kryhej duke përdorur më së shumti pasqyrën e:

- (a) Pozicionit financiar
- (b) Performancës financiare
- (c) Flukseve të mjeteve monetare
- (d) Ndryshimit të kapitalit
- (e) Shënimet shpjeguese

Përgjigja e saktë është alternativa B

9. Kthimi nga kapitali aksionar i zakonshëm (ROCE) është tregues i cili llogaritet:

- (a) $(\text{Fitimi neto} - \text{dividentët e zakonshëm}) / \text{Kapitali aksionar i zakonshëm mesatar}$
- (b) $\text{Fitimineto} / \text{kapitali aksionar i zakonshëm mesatar}$
- (c) $\text{Marzhi i fitimit i rregulluar} * \text{Qarkullimi i aktiveve} * \text{Leva financiare}$
- (d) $\text{Marzhi i fitimit i rregulluar} * \text{Qarkullimi i aktiveve}$
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa C

10. Cili nga të mëposhtmet nuk është element i kostos së prodhimit

- (a) Shpenzime për qiratë e fabrikës
- (b) Shpenzime për qiratë e zyrave të departamentit të shitjes
- (c) Shpenzime për pagat e punonjësve të prodhimit
- (d) Shpenzime për paketimin e produkteve të prodhuara
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa B

11. Sipas, SKK, Instrumenti Financiar është:

- (a) Një kontratë që lidhet vetëm me blerjen ose shitjen e mallrave
- (b) Një dokument që përfaqëson një titull pronësie mbi aksionet e një shoqërie aksionare
- (c) Një marrëveshje ortakësh që lidhet vetëm me shpërndarjen e dividendëve
- (d) Një kontratë që krijon një aktiv financiar për njërën palë dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për palën tjetër
- (e) Një kontratë që krijon një obligacion të konvertueshëm në aksione, në varësi të vlerës së aksioneve në treg

Përgjigja e saktë është alternativa D

12.Sipas SKK, të ardhurat dhe shpenzimet që krijohen si rezultat i aktiviteteve të rastësishme gjatë ndërtimit apo zhvillimit të një aktivi afatgjatë material, aktivitete këto të panevojshme për ta sjellë aktivin në vendndodhjen dhe kushtet e shfrytëzimit nga drejtimi, njihen në:

- (a) Koston e aktivit për vlerën neto
- (b) Drejt për drejt në zërat e kapitalit
- (c) Në të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës
- (d) Në cash – flow
- (e) Kapilizohen si zë më vete në të ardhura dhe shpenzime të shtyra

Përgjigja e saktë është alternativa C

13.Sipas SNK 38 “Aktivet jo-materiale”, përkufizimi i një aktivi jo-material kërkon që aktivi jo-material të jetë i identifikueshëm për ta dalluar atë nga emri i mirë. Cilat prej kushteve me poshtë duhet te plotesoje nje aktiv per t’u konsideruar i identifikueshem?

- (a) Është i ndashëm, d.m.th. ka mundësi të ndahet apo të veçohet nga njësia ekonomike
- (b) Ka mundësi të shitet, transferohet, licencohet, jepet me qira dhe këmbehet,
- (c) veprimet e dy alternativave me lart mund te kryhen qoftë individualisht apo së bashku me një kontratë, aktiv ose detyrim të lidhur, megjithëse njësia ekonomike vendos kështu
- (d) Vjen nga të drejtat kontraktuale apo të drejta të tjera ligjore, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme apo të ndashme nga njësia ekonomike ose nga të drejta apo detyrime të tjera;
- (e) Te gjitha me lart

Përgjigja e saktë është alternativa E

14.Sipas SNK 21“Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit” cili prej përkufizimeve te mëposhtme eshte i sakte ne lidhje me termin “Kursi i mbylljes”?

- (a) Kursi i mbylljes NUK është kursi i këmbimi i çastit (spot) në fund të periudhës së raportimit.
- (b) Kursi i mbylljes është kursi i këmbimit i çastit (spot) në fund të periudhës së raportimit.
- (c) Kursi i mbylljes është kursi i këmbimit i se ardhmes (forward) në fund të periudhës së raportimit
- (d) Kursi i mbylljes është kursi i këmbimi i percaktuar ne nje marreveshje kontraktuale mes 2 ose me shume paleve të mirë informuara dhe pjesëmarrës të tregut.
- (e) Kursi i mbylljes është çdo monedhë tjetër, përveç monedhës funksionale të njësisë ekonomike.

Përgjigja e saktë është alternativa B

15.Një kompani nënshkruan një kontratë ku ofron një pajisje dhe shërbim mirëmbajtjeje 3-vjeçare. Çmimi i kontratës është 120,000 euro. Pajisja ka çmim të pavarur shitjeje 100,000 euro dhe mirëmbajtja 30,000 euro. Si duhet të alokohet çmimi i transaksionit?

- (a) 100,000 për pajisjen dhe 20,000 për mirëmbajtjen
- (b) 90,000 për pajisjen dhe 30,000 për mirëmbajtjen
- (c) 92,308 për pajisjen dhe 27,692 për mirëmbajtjen
- (d) 120,000 për pajisjen dhe 0 për mirëmbajtjen
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa C

16.Një makineri ka vlerë kontabël 200,000 euro. Vlera e saj e përdorimit (value in use) është 150,000 euro dhe vlera e drejtë neto nga shitja është 160,000 euro. Sa duhet të jetë humbja nga zhvlerësimi?

- (a) 40,000 euro
- (b) 50,000 euro
- (c) 200,000 euro
- (d) Nuk ka humbje nga zhvlerësimi
- (e) Asnjë nga të mesipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa A

17.Cilat njësi ekonomike nuk e kanë detyrim ligjor përgatitjen e Raportit të Ecurisë të veprimtarisë:

- a) Mikronjësiti
- b) Njësiti e vogla ekonomike
- c) OJF me të ardhura nën 30 milion lekë
- d) Të gjitha më sipër
- e) Vetëm (a) dhe (c)

Përgjigja e saktë është alternativa D

18.Kompania Z raporton interesa të paguara prej 500,000 €, dividendë të marrë prej 200,000 € dhe dividendë të paguar prej 400,000 €.

Sipas SNK 7, cili klasifikim lejohet nëse kompania dëshiron të maksimizojë flukset e parave të gatshme operative duke zbatuar në mënyrë të qëndrueshme zgjedhjet e lejuara të politikave të standardit?

- (a) Interesi i paguar: Operativ; Dividentë të marrë: Investues; Dividentë të paguar: Financues
- (b) Interesi i paguar: Financues; Dividentë të marrë: Operativ; Dividentë të paguar: Financues
- (c) Interesi i paguar: Operativ; Dividentë të marrë: Operativ; Dividentë të paguar: Financues
- (d) Interesi i paguar: Financues; Dividentë të marrë: Investues; Dividentë të paguar: Operativ
- (e) Interesi i paguar: Operativ; Dividentë të marrë: Financues; Dividentë të paguar: Investues

Përgjigja e saktë është alternativa B

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

Pyetje 1: Sipas SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabime” perkufizoni termat: zbatim retrospektiv dhe zbatim prospektiv.

Përgjigje:

Zbatim retrospektiv është zbatimi i një politike të re kontabël për transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera sikur kjo politikë të ishte **zbatuar përgjithmonë**. (2 pike)

Zbatimi prospektiv i një ndryshimi në politikat kontabël dhe njohja e efektit të një ndryshimi në një vlerësim kontabël, përkatësisht, janë (2 pike):

- (a) zbatimi i një politike të re kontabël ndaj transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera që ndodhën **mbas datës në të cilën u ndryshua politika**; (1 pike)
- (b) njohja e efektit të ndryshimit në vlerësimin kontabël **në periudhën aktuale dhe ato të ardhshme** që ndikohen nga ndryshimi. (1 pike).

Pyetje 2: Analizoni rëndësinë e informacionit jofinanciar (mjedisor, social, qeverisje) në vendimmarrjen e investitorëve. Si e plotëson ai raportimin financiar tradicional? Jepni shembuj nga praktika ndërkombëtare.

Përgjigje:

Informacioni jofinanciar (ESG – mjedisor, social, qeverisje) ka rëndësi të veçantë në raportimin e bizneseve, pasi ndihmon investitorët të vlerësojnë jo vetëm performancën financiare, por edhe qëndrueshmërinë, etikën dhe rreziqet afatgjata të një kompanie. Ai ofron një pamje më të plotë të aftësisë për të gjeneruar përfitime të qëndrueshme dhe ndihmon në identifikimin e rreziqeve që nuk shfaqen në pasqyrat financiare tradicionale, si rreziqet mjedisore dhe qeverisja e dobët. (2 pikë)

Për investitorët, informacioni jofinanciar lehtëson vendimmarrjen mbi investime etike dhe të qëndrueshme, duke plotësuar pasqyrat financiare tradicionale dhe duke forcuar transparencën dhe besueshmërinë e raportimit. Shembuj ndërkombëtarë përfshijnë Unilever, që raporton ndikimin mjedisor dhe social si pjesë e “Sustainable Living Plan”; Microsoft, që përfshin objektivat e neutralitetit karbonik dhe diversitetit; dhe Tesla, që thekson reduktimin e emetimeve dhe inovacionin energjetik. (1 pikë)

Pra, informacioni jofinanciar plotëson raportimin financiar tradicional, duke ofruar një pasqyrë të balancuar midis fitimit ekonomik dhe përgjegjësisë shoqërore, dhe ndikon drejtpërdrejt në besimin dhe vendimmarrjen e investitorëve. (1 pikë)

Pyetje 3: Argumentoni pse janë të nevojshme shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Cfarë duhet të përmbajnë shënimet shpjeguese?

Përgjigje:

Shënimet shpjeguese janë të nevojshme, sepse plotësojnë pasqyrat financiare, duke dhënë përshkrime me fjalë, zbrëthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk

kualifikohen për njohje në këto pasqyra, me qëllim leximin e informacionit të dobishëm nga ana e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Sipas SKK 2 (PG 86-94), Shënimet shpjeguese përmbajnë:

- a- një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- b- një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara;
- c- informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës;
- d- supozimet kyçe lidhur me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit;
- e- shpjegime mbi palët e lidhura;
- f- shënime të tjera shpjeguese, sipas kërkesave të SKK – përkatëse, të nevojshme për të kuptuar plotësisht pasqyrat financiare.

Pyetje 4: Cilët janë faktorët kryesorë që drejtimi duhet të marrë parasysh, kur përcakton jetën e dobishme të një aktivi? Si duhet të trajtohet nga njësia, ndryshimi i mëvonshëm i këtyre faktorëve?

Përgjigje:

Faktorët të cilët duhet të konsiderohen nga drejtimi, në përputhje me PG 31 të SKK 5, në përcaktimin e jetës së dobishme të një aktivi, janë:

- a - përdorimi i pritshëm i aktivit, referuar kapaciteteve të pritshme të aktivit ose prodhimit të pritshëm.
- b - konsumimi fizik i pritshëm, që varet nga faktorë të shfrytëzimit, të tillë si numri i turneve gjatë të cilave aktivi përdoret, planet e riparimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe kujdesin dhe mirëmbajtjen e aktivit, kur aktivi nuk është në punë.
- c - vjetërimi teknik ose tregtar, që rrjedh nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në kërkesat për produktin apo shërbimin e siguruar nga aktivi.
- d - kufizimet ligjore apo të ngjashme për përdorimin e aktiveve, siç janë datat e skadimit të kontratave të qirasë, etj.

Një ndryshim i mëvonshëm i faktorëve të mësipërm të konsideruar nga drejtimi njësisë, mund të tregojnë se vlera e mbetur apo jeta e dobishme e një aktivi ka ndryshuar që nga data e fundit e raportimit vjetor. Nëse tregues të tillë janë të pranishëm, një njësi ekonomike do të shqyrtojë vlerësimet e saj të mëparshme dhe nëse pritshmëritë ndryshojnë, atëherë njësia do të ndryshojë vlerën e mbetur, metodën e amortizimit ose jetën e dobishme. Njësia ekonomike do ta trajtojë ndryshimin në vlerën e mbetur, metodën e amortizimit ose jetën e dobishme si një ndryshim në një vlerësim kontabël sipas PG 37 të SKK 5.

Pyetje 5: Argumentoni pse është e rëndësishme që inventaret të maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot e shitjes. Si ndikon ky element në pasqyrat financiare?

Përgjigje:

Sipas SKK 4 – Inventarët, matja e mëpasshme e inventarëve me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur, është thelbësore për të siguruar që pasqyrat financiare të pasqyrojnë në mënyrë të vertetë dhe të besueshme gjendjen financiare të njësisë ekonomike. Ky vlerësim i mëpasshëm mbështetet në parimin e kujdesit (prudencës), i cili kërkon që aktivet dhe të ardhurat të mos mbivlerësohen, ndërsa humbjet e mundshme të njihen menjëherë sapo të identifikohen.

Ky parim bëhet veçanërisht i rëndësishëm, në situatat kur ka rënie të çmimeve të shitjes, rritje të kostove të përfundimit ose shitjes, dëmtimeve të inventarit, apo ngadalësimit të qarkullimit të tij, pasi në këto rrethana çmimi i vlerësuar i shitjes pakësuar me kostot për tu përfunduar dhe shitur, mund të bjerë nën koston e inventarit. Në këto rrethana, njësia ekonomike duhet të njohë zhvlerësimin e inventarit në momentin që ky i fundit ndodh, për të reflektuar realisht vlerën që pritet të rikupërohet nga shitja e inventarit.

Ky trajtim ndikon drejtpërdrejt në pasqyrat financiare, duke:

- Ulur vlerën e inventarit në pasqyrën e pozicionit financiar;
- Rritur shpenzimet e periudhës përmes njohjes së humbjes nga zhvlerësimi dhe zvogëluar fitimin;
- Rritur besueshmërinë dhe vërtetësinë në raportimin financiar.

Pyetje 6: Në lidhje me aktivet jo-materiale të zhvilluara brenda njësisë ekonomike, si mund të menaxhohet gjykimi subjektiv në njohjen fillestare dhe kapitalizimin e shpenzimeve të zhvillimit, duke siguruar që pasqyra financiare të ofrojë informacion të saktë dhe të krahasueshëm për përdoruesit?

Përgjigje:

Për aktivet jo-materiale të zhvilluara brenda njësisë ekonomike, gjykimi subjektiv menaxhohet duke zbatuar kritere të qarta të njohjes, si fizibiliteti teknik, qëllimi për përfundim dhe përdorim, aftësia për të gjeneruar përfitime ekonomike të ardhshme dhe disponueshmëria e burimeve të nevojshme. Njësia duhet të demonstrojë se projekti është teknikisht i realizueshëm, ekziston qëllimi dhe aftësia për ta përfunduar dhe përdorur aktivin, dhe se ai pritet të gjenerojë përfitime ekonomike konkrete. Po ashtu, duhet të verifikohet disponueshmëria e burimeve financiare, njerëzore dhe teknike për ta përfunduar zhvillimin dhe për ta përdorur aktivin në mënyrë efektive. (2 pikë)

Subjektiviteti reduktohet përmes politikave të dokumentuara kontabël, dokumentimit të plotë të procesit të zhvillimit, rishikimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe zbulimeve të plota dhe transparente në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Këto masa sigurojnë që informacioni i raportuar të jetë i besueshëm, i matur dhe i krahasueshëm midis periudhave dhe njësive. Shembull: Kompanitë farmaceutike psh kapitalizojnë vetëm projektet që kanë kaluar fazën e provës teknike dhe janë të gatshme për përdorim tregtar. (2 pikë)

Pyetje 7: Për secilin situatë, diskutoni marrëdhëniet e palëve të lidhura që lindin bazuar në Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura.

Situata 1: Zoti P, individ, zotëron 70% të njësisë A dhe 30% të njësisë B.

Shpjegoni nëse entiteti A dhe entiteti B janë palë të lidhura. (1 pikë)

Situata 2: Zoti P, individ, zotëron 25% të njësisë A dhe 30% të njësisë B.

Shpjegoni nëse entiteti A dhe entiteti B janë palë të lidhura. (1 pikë)

Situata 3: Zoti P, individ, zotëron të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të entitetit A. Ai gjithashtu është anëtar i personelit drejtues kryesor të entitetit B, i cili, entiteti B zotëron të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të entitetit

Diskutoni marrëdhëniet e palëve të lidhura që lindin nga struktura e mësipërme.(2 pikë)

Përgjigje:

Situata 1: Z. P është një palë e lidhur e entitetit A dhe entitetit B, pasi ai është në gjendje të ushtrojë kontroll ose ndikim të rëndësishëm mbi secilin entitet. (1 pikë)

Zoti. P kontrollon entitetin A dhe ka ndikim të rëndësishëm mbi entitetin B. Prandaj, A dhe B janë palë të lidhura.

Situata 2: Z. P është një palë e lidhur e entitetit A dhe entitetit B, pasi ai është në gjendje të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi secilin entitet.

Zoti. P nuk kontrollon as entitetin A as entitetin B. Prandaj, A dhe B nuk janë palë të lidhura.

Situata 3: Z. P ka kontroll mbi entitetin A, që do të thotë që Z. P është një palë e lidhur e A.

Zoti. P është anëtar i personelit kryesor drejtues të B, kështu që është një palë e lidhur e B.

A dhe B janë palë të lidhura, sepse Zoti. P kontrollon A dhe është anëtar i personelit drejtues kryesor të B.

Entiteti B kontrollon entitetin C, kështu që B dhe C janë palë të lidhura.

Z. P është anëtar i personelit drejtues kryesor të mëmës së C, kështu që Zoti. P dhe entiteti C janë palë të lidhura.

Kjo do të thotë që entitetet A dhe C janë gjithashtu palë të lidhura (Zoti. P kontrollon entitetin A dhe është anëtar i personelit drejtues kryesor të kompanisë mëmë të C).

Ushtrimi 1 (6 pikë)

Të dhënat janë:

	Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B
Çmimi	35\$	30\$
EPS	1.60 \$	0.90 \$
Raporti P/E	21.9 herë	33.3herë
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (milion)	(16.272) \$	(1.757) \$
Aksione (milion)	22.6	25.1

Si pjesë e shqyrtimit të këtij përfundimi, analisti vendos të shqyrtojë pyetjen: Si do të dukej raporti (P/E) i kompanisë nëse do të përdoreshin të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për aksion - në vend të të ardhurave neto për aksion ?

Përshkruani një raport për përgjigjen e pyetjes së ngritur nga analisti.

Përgjigje:

Njësia ekonomike A	Njësia ekonomike B	
Çmimi	35\$	30\$
EPS	1.60 \$	0.90 \$
Raporti P/E	21.9 herë	33.3herë
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (milion)	(16.272) \$	(1.757) \$
Aksione (milion)	22.6	25.1
EPS bazuar në ardhura gjithëpërfshirëse	0.88 \$	0.83 \$

EPS + Të ardhurat gjith. për aksion

$$1.6+ (16.272/22.6) dhe 0.90+(1.757/25.1)$$

Kujdes: të ardhurat gjithëpërfshirëse rezultojnë “humbje”

Çmimi /EPS gjithëpërfshirëse **39.8 herë** **36.1herë**

Konstatohet nga të dhënat se për kompaninë A të ardhurat gjithëpërfshirëse rezultojnë humbje shumë më të lartë se të kompanisë B, kjo sjell që raporti Çmim/Fitim i kompanisë A të jetë më i ulët. Mos përfshirja e humbjeve bën të mundur që raporti P/E të jetë më i lartë. Prandaj duhet kujdes në llogaritjen e këtij raporti duke ditur që njësia ekonomike mund të paraqesë pasqyrën e performancës në dy formate tipe.

Mospërfshirja në raport e fitim/humbjeve të përealizuara gjatë periudhës është element parësor në analizën e përfitueshmërisë së njësisë ekonomike

Ushtrimi 2 (6 pikë)

Shoqëria AlbaLight Shpk përdor sistemin e kostos së prodhimit të vazhdueshëm dhe tre elementët e koston hidhen në mënyrë uniforme. Për llogaritjen e koston së inventarëve përdor metodën mesatare të ponderuar. Të dhënat e mëposhtme janë shkëputur nga librat kontabël të njësisë ekonomike dhe pasqyrojnë operacionet e prodhimit gjatë muajit Janar:

Kostot e prodhimit (mijë lekë)

Prodhi në proces në fillim të periudhës:

Kostoja e transferuar nga reparti i parë	250 000
Materiale	25 000
Punë	23 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit.	10 000

Kostot e kryera gjatë muajit:

Kostoja e transferuar nga reparti i parë	450 000
Materiale	100 000
Punë	75 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit.	60 000

Raporti i prodhimit

Njësitë

Prodhi në proces, në fillim të periudhës,	20 000 i cili ishte
2/3 i përpunuar	
Të përfunduara dhe të transferuara në magazinë gjatë muajit.	120 500
Prodhi në proces, në fund të periudhës, gjysmë i përfunduar.	34 500

Kërkohet të përgatishni një raport të kostove të prodhimit për muajin Janar.

Përgjigje:

Raporti i Koston së prodhimit muaji Janar

1. Kostot totale për tu analizuar (Grumbullimi i kostove-faza e parë) në mijë Lekë

Kostoja e Prodhimit në proces gjendje në fillim të periudhës: 308 000

Kostoja e transferuar nga reparti i parë	250 000
Materiale	25 000
Punë.	23 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit.	10 000

Kostoja e transferuar nga reparti i parë 450 000

Kostot e kryera gjatë muajit në repartin e dytë 235 000

Materiale	100 000
Punë	75 000
Shpenzime të përgjithshme të prodhimit.	60 000

Kostot totale për tu analizuar gjatë periudhës 993 000

2. Përcaktimi i njësive ekuivalente (tre elementët hidhen uniformë, si rrjedhojë njësitet ekuivalente janë të barazvlefshme si në MD, PD dhe SHPP)

Përshkrimi

Njësi ekuivalente MD: PD: SHPP

Të përfunduara dhe të transferuara në magazinë gjatë muajit. 120 500 * 100%= 120 500
 Prodhimi në proces, në fund të periudhës, gjysmë i përfunduar. 34 500* 1/ 2 = 17 250
Totali **137 750**

3. Kostoja totale e prodhimit për njësi ekuivalente

MD (25 000+ 100 000) / 137 750 ~ **0.907**
 PD (23 000+ 75 000) / 137 750 ~ **0.712**
 SHPP (10 000+ 60 000) / 137 750 ~ **0.51**
KTP / njësi ekuivalente në Repartin e dytë = 2.127

KTP mesatare e transferuar nga Reparti i parë = (250 000+ 450 000) / (20 000 +135 000)=4.516

Për të gjetur njësitet e hedhura dhe të transferuara nga reparti i parë, gjatë periudhës përdorim formulën

Prodhim në proces gjendja në fillim + të hedhura gjatë periudhës = Përfunduar e transferuar + PP gjendje fund.

20 000 + Të hedhura gjatë periudhës dhe transf. Rep i parë = 120 500+34 500 = **135 000 njësi**

4. Kostot e inventarëve

Kostoja e prodhimit të përfunduar në repartin e dytë dhe transferuar të 120 500 njësive është 800 503 mijë lekë

Kostoja e mbartur nga Reparti i Parë = 120 500 * 4.516 =544 194 mijë lekë

Kostoja e Repartit të dytë = 120 500* 2.127 = 256 309 mijë lekë

Kostoja e Prodhimit në proces gjendje në fund për 34 500 njësi fizike është 192 497 mijë lekë

Kostoja e mbartur nga Reparti i parë = **34 500** *4.516 = 155 806 mijë lekë

Kostoja e PP gjendje në fund në Repartin e dytë 36 691 mijë lekë

MD = 17 250* 0.90744= 15653

PD = 17 250 *0.711 = 12 272

SHPP = 17 250 * 0.508 = 8 766

KOSTOT TOTALE 993 000 mijë lekë (800503+192497) (shënim: shifrat janë të rrumbullakosura)

Ushtrimi 3 (6 pikë)

Drejtimi shoqërisë Best Trade shpk, pasi vlerësoi ecurine jo të mirë financiare të shoqërisë, vendosi rishikimin e aktivitetit të saj. Në fillim të dhjetorit 2024, pas një sërë diskutimesh dhe konsultimesh të gjëra, drejtimi paraqiti planin e rishikimit, të cilin e shpalli publikisht dhe vendosi për nisjen e zbatimit të tij. Drejtuesit kanë parashikuar një sërë shpenzimesh, të cilat paraqiten si mëposhtë, por janë ende në diskutim se cilat nga këto kosto, nëse do të ketë të tilla, do të çojnë në krijimin e një provizionit.

Përshkrim	Vlerë
shpenzimet e çmontimit të pikave të shitjes	20,000
Shpenzimet për mbylljen e parakohshme të kontratave të qirasë	40,000
shpenzimet e ndërprerjes së kontratave me personelin	30,000
ripozicionimi i personelit që vazhdon marrëdhëniet e punës	25,000
shpenzimet e marketingut dhe ribrandimit	5,000
humbjet e ardhshme të shfrytëzimit nga dyqanet	30,000
Total Plani	170,000

Në 2025, nga realizimi i detyrimeve për ndërprerjen e kontratave të punës në vlerë më të ulët se sa vlera e parashikuar e detyrimit, përkatësisht diferenca e rezultuar në vlerën 15,000 lekë, drejtimi njësisë vendosi ta përdorë këtë vlerë, për shpërndarjen e një shpërblimi për stafin drejtues të shoqërisë.

Kërkohet:

a) Të përcaktohet nëse për mbushen kushtet për njohjen e një provizionit, dhe sa është vlera që duhet të krijohet dhe të paraqitet në pasqyrat financiare? (3 pikë)

Përgjigje:

a) Bazuar në të dhënat e ushtrimit, përmbushen kushtet për njohjen e një provizionit për rishikim në përputhje me SKK 6, pasi janë plotësuar dy elementët thelbësorë:

(i) Ekziston një detyrim aktual konstruktiv – në këtë rast, drejtimi ka miratuar një plan të detajuar për rishikimin, i cili përcakton qartë fushën e veprimit, njësitë e prekura, vendndodhjen, numrin e përafërt të punonjësve që preket nga rishikimi, shpenzimet që do të kryhen dhe periudhën e zbatimit të planit.

(ii) Shoqëria ka krijuar një pritshmëri të vlefshme tek palët e prekura (punonjës, qiradhënës, etj.) se rishikimi do të realizohet, përmes njoftimit publik dhe nisjes së zbatimit të planit në dhjetor 2024.

Shuma me të cilën provizioni do të njihet përfshin, vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta që ndodhin vetëm njëherë, si rezultat i zbatimit të programit të rishikimit, dhe që nuk janë të lidhura me veprimtaritë e njësisë ekonomike pas rishikimit, si mëposhtë:

Përshkrim	Vlerë
shpenzimet e çmontimit të pikave të shitjes	20,000
shpenzimet për mbylljen e parakohshme të kontratave të qirasë	40,000
shpenzimet e ndërprerjes së kontratave me personelin	30,000
Total Plani	90,000

b) Si do të trajtohet vendimmarrja e drejtimit të njësisë për shpërblimin në 2025? (3 pikë)

Përgjigje:

Shuma prej 15,000 lekësh, e përdorur nga drejtimi i njësisë për shpërblimin e stafit drejtues, është përdorur në mënyrë të gabuar, pasi provizioni nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera nga ato për të cilat është krijuar fillimisht. Kjo shumë, si pjesë e provizionit të përealizuar, duhet të rimerret në “të ardhura nga kthimi i provizionit të përealizuar”. Më tej, drejtimi duhet të njohë shpenzimin e personelit në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Ushtrimi 4 (6 pikë)

Shoqëria Real Estate sh.p.k., në 3 janar 2024 finalizon blerjen e një ndërtese 3 katëshe, së bashku me truallin mbi të cilin qëndron ndërtesa, për vlerën 80,000,000 lekë, me qëllimin për të transferuar administratën nga një ambient me qira ku ndodhen aktualisht. Sipas cmimit të tregut për meter katror për ndërtesa të ngjashme, vlerësohet se vlera e ndërtesës përbën 80% të çmimit të blerjes. Në 5 janar 2024 administrata transferohet plotësisht në ndërtesën e re. Drejtimi zgjedh të zbatojë modelin e rivlerësimit për matjen e mëpasshme. Jeta e dobishme e vlerësuar e ndërtesës është 40 vjet, ndërsa vlera e mbetur 0 lekë.

Në fillim të qershorit 2025, drejtimi cakton një vlerësues për rivlerësimin e vlerës së ndërtesës, si pasojë e ndryshimit të kushteve dhe rrethanave në treg. Raporti i dorëzuar në 30 qershor 2025 vlerëson vlerën e drejtë të ndërtesës në 75,000,000 lekë ndërsa tokën në 22,000,000 lekë. Në 31.12.2025, në kuadër të ristrukturimit, shoqëria shet 30% të ndërtesës dhe truallit për vlerën 30,000,000 lekë, duke hyrë në bashkëpronësi me shoqërinë Alfa shpk.

Kërkohet:

- Pasqyroni veprimet kontabël të njohjes fillestare. (1 pikë)
- Pasqyroni veprimet kontabël për vitin e mbyllur në 31.12.2024. (1 pikë)
- Pasqyroni veprimet kontabël në momentin e rivlerësimit. (2 pikë)
- Pasqyroni veprimet kontabël për vitin e mbyllur në 31.12.2025. (2 pikë)

Përgjigje:

- a) Regjistrimi i blerjes së ndërtesës dhe truallit në datën 3 janar 2024 në njohjen fillestare:

Cmimi total I transaksionit	80,000,000 lekë	
Toka – Debi (20% x cmimi total)	16,000,000 lekë	
Ndërtesa - Debi (80% x cmimi total)	64,000,000 lekë	
Mjete Monetare - Kredi		80,000,000 lekë

- b) Për vitin e mbyllur në 31.12.2024, drejtimi njësisë do të llogarisë amortizimin për vitin, vetëm për ndërtesën e cila shfrytëzohet për qëllime administrative, mbi bazën e jetës së dobishme të vlerësuar 40 vjet dhe vlerës së mbetur 0 (zero lekë), si më poshtë:

Shpenzime amortizimi ndërtesa - Debi	1,600,000 lekë	
Te Amortizimi akumuluar ndërtesa - Kredi		1,600,000 lekë

Llogaritja amortizimit = 64,000,000 lekë / 40 vjet. Viti marrë i plotë.

- c) Në momentin e rivlerësimit (30.06.2025), do të llogaritet amortizimi ndërtesës deri në atë moment, dhe do të mbyllet amortizimi i akumuluar në vlerën e aktivit (Metoda Netimit). Vlera aktivit më tej do të rritet për vlerën e rivlerësuar. Veprimet kontabël paraqiten si vijon:

Shpenzime amortizimi ndërtesa - Debi	800,000 lekë	
Te Amortizimi I akumuluar ndërtesa - Kredi		800,000 lekë
Amortizimi i akumuluar ndërtesa - Debi	2,400,000 lekë	
Ndërtesa - Kredi		2,400,000 lekë
Ndërtesa - Debi	13,400,000 lekë	
Toka - Debi	6,000,000 lekë	
Rezerva Rivlerësimi Ndërtesa - Kredi		13,400,000 lekë
Rezerva Rivlerësimi Toka - Kredi		6,000,000 lekë

- d) Në 31.12.2024, llogaritet amortizimi me vlerën e rivlerësuar të ndërtesës dhe kryhet c'regjistrimi pjesor I ndërtesës si pasojë e shitjes si më poshtë:

Llogaritja Amortizimit për periudhën 01/07 – 31/12/2025:

Shpenzime amortizimi ndërtesa - Debi	974,026 lekë	
Te Amortizimi akumuluar ndërtesa - Kredi		974,026 lekë

Llogaritja: vlera rivlerësuar 75 mln lekë x (0.5 vite /38.5 vite të mbetura)

Rezerva rivlerësimi ndërtesa - Debi	174,026 lekë	
Te Fitimi pa shpërndarë (FPSH) - Kredi		174,026 lekë

Llogaritja: 13.4 mln lekë x (0.5 vite /38.5 vite të mbetura)

C'regjistrimi nga shitja e 30% të ndërtesës dhe truallit mbi ndërtesë:

Shpenzime vlere kontabël e mbetur ndërtesa & toka - Debi	28,807,792 lekë	
Amortizim I akumuluar - Debi	292,208 lekë	
Toka - Kredi		6,600,000 lekë
Ndërtesa – Kredi		22,500,000 lekë
Rezerva nga rivlerësimi toka - Debi	1,800,000 lekë	
Rezerva nga rivlerësimi ndërtesa - Debi	3,967,792 lekë	
Te Fitim I pashpërndarë (FPSH) - Kredi		5,767,792 lekë
Llogaritja: $30\% \times \text{rezerva nga rivlerësimi e mbetur për token dhe ndërtesën}$		
Mjete Monetare - Debi	30,000,000 lekë	
Të ardhura nga shitja e tokës dhe ndërtesës - Kredi		30,000,000 lekë

Ushtrimi 5 (6 pikë)

Shoqëria ONYX ka një fitim para taksave prej 200,000 € për duke ju referuar pasqyrave Financiare për vitin 2024. Të dhënat tatimore janë:

Shpenzime jo të zbritshme për qëllime tatimor: 10,000 €

Diferenca kalimtare e amortizimit (kontabël > tatimor): 5,000 €

Norma tatimore: 15%

Tatimi paraprak i paguar: 25,000 €

Kërkohet:

1. Llogarisni fitimin tatimor dhe tatimin aktual për vitin 2024. (3 pikë).
2. Llogarisni tatimin e shtyrë sipas diferencave kalimtare. (3 pikë)

Përgjigje:

1. Llogarisni fitimin tatimor dhe tatimin aktual për vitin 2024. (3 pikë)

A) Llogaritja e Fitimi tatimor:

$$\begin{aligned} \text{Fitimi tatimor} &= \text{Fitimi kontabel} + \text{Shpenzime jo të zbritshme} - \text{Diferenca kalimtare} \\ &= 200,000\text{€} + 10,000\text{€} - 5,000\text{€} = 205,000\text{€} \end{aligned}$$

B) Llogaritja e Tatimit aktual (tatim mbi Fitimin)

$$\text{Tatimi Aktual} = \text{Fitimi tatimor} \times \text{Norma Tatimore}$$

$$\text{Tatimi aktual} = 205,000\text{€} \times 15\% = 30,750\text{€}$$

Tatimi i pagueshëm në fund të vitit

$$30,750 - 25,000 = 5,750\text{€}$$

2. Llogarisni tatimin e shtyrë sipas diferencave kalimtare. (3 pikë)

Diferenca kalimtare (ose e përkohshme) është ndryshimi midis vlerës kontabël të një aktivi (ose detyrimi) dhe bazës së tij tatimore, që do të shkaktojë një tatim të pagueshëm në të ardhmen.

Tatimi I shtyrë = Diferenca kalimtare × Norma tatimore

$$= 5,000\text{€} \times 15\% = 750\text{€}$$

Tatimi i shtyrë = 750€

Ushtrimi 6 (6 pikë)

Shoqëria Mëmë Beta i jep hua filialeve të saj pa interes. Më 1 janar 2025, Shoqëria Mëmë Beta dha një hua prej 1 milion Lekë për filialin Coro me kushtet e mëposhtme: 1 milion Lekë e ripagueshme në tre vjet, në dhjetor 2027 me 0% interes. Bazuar në parashikimet aktuale të fluksit të parave, filiali C pritet të paguajë deri në dhjetor 2027. Norma e tregut për instrumenta të ngjashëm është 15%. Shoqëria përllëgarit se vlera aktuale e 1 milion Lekë në tre vjet e aktualizuar me normën e interesit të tregut prej 15% është 658,000 Lekë.

Kerkese: Sipas SNRF 9 "Instrumentet financiare" tregoni trajtimin kontabel duke pasqyruar veprimet kreditore dhe debitore në njohjen fillestare për Shoqërinë Meme Beta dhe për Filialin Coro? Argumentoni përgjigjen tuaj. (6 pike)

Përgjigje:

Për të përmbushur testin VPPI, fluksi kontraktual monetarë prej 1 milion Lekë në tre vjet duhet të përfaqësojë pagesa të principalit (duke qenë vlera fillestare e drejtë) dhe interesit (interesi i përllëgarit duke përdorur metodën e Normës së Interesit Efektiv (NIE). Vlera fillestare e drejtë do të jetë shuma e njohur në përputhje me SNRF 9 në njohjen fillestare që zakonisht është e barabartë me çmimin e transaksionit. Në këtë rast vlera fillestare e drejtë matet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare të aktualizuara me një normë të përshatshme interesi tregu për një hua të ngjashme në datën e njohjes fillestare. (1 pike)

Trajtimi kontabël i sugjeruar për Shoqërinë Meme Beta: (2 pike)

Në njohjen fillestare, Shoqëria Mëmë Beta njeh huanë si vijon:

Debi - Kredi të arkëtueshme : 658,000 Lekë
Debi - Investimi në filiale : *342,000 Lekë
Kredi - Mjete Monetare : 1 milion Lekë

*Shenim: *(1 milion LEKE – 658,000 LEKE).*

Për Filialin Coro, regjistrimi kontabël është shumë i ngjashëm: (2 pike)

Debi - Mjete Monetare : 1 milion LEKË
Kredi - Kredi të pagueshme : 658,000 LEKË
Kredi - Kapitali - kontributet e kapitalit : 342,000 LEKË

Ushtrimi 7 (6 pikë)

SNRF 16 për Epsilon Solutions SHPK

Më 15 Mars 2024, Epsilon Solutions SHPK ka nënshkruar një marrëveshje qiraje për një laborator të ri prodhimi për tre vite. Pagesat e qirasë janë 4,800,000 lekë në vit, të paguara në fillim të çdo tremujori (pra 1,200,000 lekë çdo tremujor). Norma inkrementale e kredive (IBR) është 5.5%, dhe kompania ka bërë parapagim për një tremujor në datën e fillimit. Vlera e drejtë e pronës nuk mund të përcaktohet lehtë.

Më 1 Qershor 2024, kompania nënshkroi një qira për një magazinë të përkohshme për tetë muaj. Paga totale është 480,000 lekë, e pagueshme menjëherë në fillim të qirasë. Norma inkrementale e kredive është 6%, dhe vlera e drejtë e pronës nuk mund të vlerësohet për shkak të rrethanave.

Kërkohet:

a) Llogarisni për kontratën e parë të qirasë, vlerën e aktivit me të drejtën e përdorimit dhe detyrimin e qirasë në 15 mars 2024 dhe 31 dhjetor 2024. Bëni regjistrimet kontabël në 15 mars dhe 31 dhjetor respektivisht për të gjithë zërat që preken duke ilustruar llogaritjen e shumave përkatëse bashkë me sqarimet përkatëse. (3 pikë)

Përgjigje:

Matja fillestare

Detyrimi i qirasë matet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme (pra 11 pagesat tremujore e mbetura, sepse e para u parapagua) duke përdorur normën 3 mujore të ekuivalentuar nga norma 12 mujore 1.347%. Aktivit me të drejtë përdorimi matet me vlerën e detyrimit + pagesën e bërë në fillim.

Regjistrimi 15.03.2024

Debi: Aktiv me të drejtë përdorimi	13,392,260
Kredi: Banka për parapagimin	1,200,000
Kredi: Detyrimi i qirasë	12,192,260

Amortizimi i Aktivit:

Amortizim linear për 2024 = $13,392,260 / 3 \times 10 / 12$ (mars-dhjetor) = 3,571,269 lek

Interesi dhe pagesat:

Tremujori 1: interesa = $12,192,260 \times 1.347\% \approx 164,461.2$.
Tremujori 2: interesa = $11,156,552.83 \times 1.347\% \approx 150,336.50$.
Tremujori 3: interesa = $10,106,889.33 \times 1.347\% \approx 136,192.10$.
Tremujori 1 principal = $1,200,000 - 164,461.2 = 1,035,707.17$.
Tremujori 2 principal = $1,200,000 - 150,336.50 = 1,049,663.50$.
Tremujori 3 principal = $1,200,000 - 136,192.10 = 1,063,807.90$.

Regjistrimet kontabël tjera:

Gjatë vitit 2024 (për çdo tremujor)

Debi: Shpenzim Interesi (afërsisht 451,000 total)

Debi: Detyrimi i qirasë (afërsisht 3,149,000)
Kredi: Banka 3,600,000

31.12.2024

Debi: Shpenzim amortizimi 3,571,269
Kredi: Amortizim i akumuluar aktiv me të drejtë përdorimi 3,571,269

Bilanci në 31 dhjetor 2024:

- Detyrim i qirasë në fund të vitit $\approx 9,043,000$ lek.
- Aktiv me të drejtë përdorimi $\approx 9,821,000$ lek.

b) Bëni regjistrimet kontabël për kontratën e dytë në datë 1 qershor, në njohje dhe matje fillestare dhe në 31 dhjetor respektivisht për të gjithë zërat që preken duke ilustruar llogaritjen e shumave përkatëse bashkë me sqarimet përkatëse. (2 pikë)

Sipas SNRF 16, marrëveshjet me kohëzgjatje ≤ 12 muaj (dhe kur nuk ka opsion blerjeje të mundshme) mund të trajtohen me përjashtim: nuk kapitalizohen si Aktiv me të drejtë përdorimi dhe nuk njohin Detyrim qiraje; pagesat trajtohen si shpenzim qiraje.

Regjistrimet:

01.06.2024

Debi: Parapagim qiraje (aktiv) 480,000
Kredi: Banka 480,000

Më pas, gjatë çdo muaji (ose në mbyllje vjetore total $60,000 \times 7$ muaj = 420,000 lekë)

Debi: Shpenzim qiraje 60,000
Kredi: Parapagim qiraje (aktiv) 60,000

c) Diskutoni sfidat që lindin kur vlera e drejtë e pronës nuk është e qartë, duke analizuar sesi duhet të gjykohet dhe dokumentohet vlera fillestare e aktivi, si ndikon kjo në raportimin e detyrimeve dhe shpenzimeve të qirasë dhe çfarë pasigurie mund të lindë për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe si mund të menaxhohet. (1 pikë)

Kur vlera e drejtë e kontratës së qirasë nuk mund të përcaktohet, diskontimi bëhet me normën inkrementale të huamarrjes (IBR), që pasqyron koston e financimit të qiramarrësit për një aktiv dhe afat të ngjashëm. Përzgjedhja e IBR kërkon gjykim profesional dhe dokumentim të burimit të normës, kushteve të tregut, maturitetit dhe rrezikut. Një IBR më e lartë ul vlerën fillestare të aktivit me të drejtë përdorimi (ROU) dhe detyrimeve të qirasë, ndikon në shpenzimet e interesit dhe krahasueshmërinë e pasqyrave. Për menaxhimin e pasigurisë, kërkohet dokumentim i metodës së llogaritjes, paraqitje të qarta dhe të plota të politikave dhe supozimeve, si dhe analizë ndjeshmërie në shënimet shpjeguese.

Ushtrimi 8 (6 pikë)

Atlas sh.a. është një shoqëri e cila operon në fushën e transportit tokësor të materialeve të ndërtimit. Shoqëria zotëron një pronë që e mban për rritje afatgjatë të kapitalit. Një pjesë e departamentit administrativ të subjektit zë një pjesë të vogël të elementit tokësor të pronës. Kjo pjesë e pronës nuk mund të shitet veçmas ose të jepet me qira veçmas si qira financiare.

Kerkese: Sipas SNK 40 “Aktive afat -gjata materiale të investuara” a mundet Atlas sh.a. ta klasifikojë të gjithë pronën e saj si pronë investimi? Arsyetoni përgjigjen tuaj.

Përgjigje:

Po, Atlas sh.a. mund ta klasifikojë të gjithë pronën e saj si një pronë investimi sepse pjesa tjetër e pronës së përdorur për qëllime administrative është e parëndësishme dhe e paaftë për t'u shitur veçmas ose për t'u dhënë me qira veçmas si një qira financiare. **(2 pikë)**.

SNK 40.10 parashikon që disa prona përfshijnë një pjesë që mbahet për të fituar qira ose për rritjen e kapitalit dhe një pjesë tjetër që mbahet për përdorim në prodhimin ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve ose për qëllime administrative. **(2 pikë)**

Nëse këto pjesë mund të shiten veçmas (ose të jepen me qira veçmas nën një qira financiare), Atlas sh.a. i llogarit pjesët veçmas. Nëse pjesët nuk mund të shiten veçmas, e gjithë pasuria është pronë investuese vetëm nëse një pjesë e parëndësishme mbahet për përdorim në prodhimin ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve ose për qëllime administrative. **(2 pikë)**

Ushtrimi 9 (6 pikë)

Orion Group është një kompani industriale e larmishme që përgatit pasqyrat e saj financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të.

Më 1 janar 2024, Orion bleu 30% të aksioneve në Stellar Motors Ltd., një kompani e angazhuar në prodhimin e automjeteve elektrike.

Ky aksion i jep Orion ndikim të konsiderueshëm, por jo kontroll mbi Stellar (Orion ka përfaqësim në bord dhe merr pjesë në vendimet kryesore të politikave).

Detajet e Blerjes:

- Çmimi i blerjes (për 30% të interesit): 9,000,000 €
- Vlera kontabël e aktiveve neto të Stellar më 1 janar 2024: 20,000,000 €
- Rregullimet e vlerës së drejtë në blerje: Aktivet afatgjata materiale të nënvlerësuar me 1,500,000 € (jeta e mbetur 10 vjet, amortizimi linear).
- Nuk ka tregues të zhvlerësimit të emrit të mirë në blerje.

Rezultatet Financiare të Stellar Motors

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024:

- Fitimi neto pas taksave: 4,000,000 €
- Dividendët e deklaruar dhe të paguar: 1,200,000 €

Në fund të vitit, menaxhmenti i Orion vlerësoi se vlera e drejtë e investimit të Orion ishte 10,500,000 €.

Ngjarje Shtesë

1. Vlerësimi i Zhvlerësimit

Më 31 dhjetor 2024, nuk ka indikacione për zhvlerësim në investim përveç paqëndrueshmërisë së tregut. Shuma e rikuperueshme e investimit vlerësohet në 8,700,000 €.

2. Ndryshimi në Pronësi

Më 1 korrik 2025, Orion blen një pjesë marrje shtesë prej 10% në Stellar Motors për 4,000,000 €, duke e rritur pronësinë e saj në 40%. Orion vazhdon të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm (ende pa kontroll).

Kërkohet:

1. Njohja Fillestare

Llogaritni pjesën e Orion në asetet Motors Stellar në momentin e blerjes dhe përcaktoni nëse lind ndonjë emër i mirë. (2 pikë)

2. Vlera Kontabël e Investimit më 31 Dhjetor 2024

Përcaktoni vlerën kontabël mbyllëse të investimit duke përdorur metodën e kapitalit. (3 pikë)

3. Rritja e pjesëmarrjes

Shpjegoni trajtimin kontabël kur Orion rrit pjesëmarrjen e tij nga 30% në 40% duke ruajtur ndikim të rëndësishëm. (1 pikë)

Përgjigje:

1. Njohja Fillestare

Pjesa e Orion në aktivet neto: $30\% \times (20,000,000 \text{ €} + 1,500,000 \text{ €}) = 6,450,000 \text{ €}$

Çmimi i blerjes: 9,000,000 €

Emri i mirë: $9,000,000 \text{ €} - 6,450,000 \text{ €} = 2,550,000 \text{ €}$

2. Vlera Kontabël e Investimit më 31 Dhjetor 2024

Balanca fillestare (kostoja fillestare) 9,000,000 €

Balansca fillestare i investimit më 1 janar 2024 është 9,000,000 € (çmimi i blerjes).

Shifra prej 6,450,000 € përdoret vetëm për llogaritjen e brendshme të emrit të mire, por nuk është shuma e regjistruar si vlera kontabël fillestare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Pjesëmarrja në fitim 1,200,000 € ($30\% \times €4,000,000$)

Dividendët (360,000 €) ($30\% \times €1,200,000$)

Amortizimi i rregullimit të vlerës së drejtë (45,000 €)

- Amortizimi i PPE-ve për 1,500,000 € gjatë 10 viteve = 150,000 € në vit
- Pjesa e Orion: $30\% \times 150,000 \text{ €} = 45,000 \text{ €}$ (zvogëlon pjesën e fitimit)

Vlera Kontabël e Investimit më 31 Dhjetor 2024: $9,795,000 \text{ €} = 9,000,000 + 1,200,000 - 360,000 - 45,000$

Edhe pse vlera e drejtë është 10,500,000 €, investimi mbahet me shumën e metodës së kapitalit, përveç nëse është i zhvlerësuar.

Shuma e rikuperueshme 8,700,000 €. Vlera kontabël 9,795,000 €.

Meqënëse, shuma e rikuperueshme është më e ulët se vlera kontabël, Orion duhet të regjistrojë një humbje nga zhvlerësimi prej 1,095,000 €.

Vlera e Investimit më 31 Dhjetor 2024 do të paraqitet në shumën 8,700,000 €.

3. Rritja e pjesëmarrjes

Kur rrit interesin e tij, por ende ruan ndikim të rëndësishëm:

- Trajtohet si një blerje shtesë të një investimi në pjesëmarrje.
- Shtohet kosto 4,000,000 € në vlerën kontabël të investimit.
- Nuk rimatet vlera e interesit të mbajtur më parë (sepse nuk fitohet kontrolli).